



**Albanian Media Institute
Instituti Shqiptar i Medias**



MONITORIM

PËR
ZBATIMIN
E LIGJIT
PËR
MEDIAT
AUDIOVIZIVE

Tiranë 2015

MONITORIM PËR ZBATIMIN E LIGJIT PËR MEDIAT AUDIOVIZIVE

(QERSHOR 2015)

Ky dokument është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit European. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësia e vetme e Institutit Shqiptar të Medias dhe në asnjë rrethanë nuk mund të konsiderohet se pasqyron pozicionin e Bashkimit European.

Hyrje

Ligji Për Mediat Audiovizive u miratua në mars 2013 dhe ishte një ndërhyrje e rëndësishme në kuadrin ligjor për median. Ligji u hartua pas një periudhe të gjatë diskutimesh, ku të dyja krahët politikë ranë dakord për gjithçka, përveç formulës së zgjedhjes së rregullatorit AMA dhe Këshillit Drejtues të RTSH.

Dy vjet pas miratimit të ligjit, zbatimi i tij ka qenë shumë i ngadaltë. Arsyeja kryesore ka të bëjë pikërisht me mungesën e vullnetit politik për të rënë dakord për mënyrën e zgjedhjes së autoriteteve rregullatore, por edhe me mënyrën se si është ndërtuar dhe zhvilluar peizazhi mediatik në Shqipëri. Ky monitorim do të trajtojë pikërisht cilat kanë qenë hapat kryesorë të hedhur për të zbatuar ligjin dhe ku qëndrojnë problemet dhe sfidat që pengojnë ose ngadalësojnë zbatimin e ligjit.

Monitorimi i Ligjit Për Mediat Audiovizive do të thotë para së gjithash monitorim i autoritetit rregullues — Autoriteti për Mediat Audiovizive (AMA)- dhe i televizionit publik. Duke pasur parasysh momentin, monitorimi i zbatimit të ligjit duhet të përfshijë edhe monitorimin e procesit të kalimit në transmetime numerike dhe rolin e këtyre dy institucioneve në këtë aspekt si përgjegjëse të drejtpërdrejta në zbatimin e tij.

Vështrim i shkurtër mbi historinë e legjislacionit të medias në Shqipëri

Që në vitin 1990, pas dekadash kontrolli të qeverisë mbi shtypin, media shqiptare u përball me një horizont të ri lirie. Lindja e medias së pavarur, natyrshëm, u shoqërua me presion politik gjithnjë në rritje si dhe me një mungesë të theksuar profesionalizmi të gazetarëve. Këto fenomene deri në një farë mase u shpjeguan me mungesën e një kuadri të përshtatshëm ligjor.

Për shkak të kontekstit dhe zhvillimit historik, politika për mediat në Shqipëri ka qenë thuajse gjithmonë reagim ndaj zhvillimeve në terren. Profesionistët dhe industria e medias kanë qenë më të shpejtë për të reaguar ndaj situatave në zhvillim dhe zhvillimeve mediatike, ndërsa ligjvënësit kanë qenë gjithmonë pas.

Ndërhyrjet e para legislative që u përpoqën të disiplinonin sjelljen e profesionistëve të medias ndodhën në 1993, kur asambleja e atëhershme miratoi Ligjin Nr. 7756 "Për shtypin". Ligji shqiptar u përshtat nga ligji i shtetit gjerman të Vestfalisë dhe pati shumë pak përpjekje për ta përshtatur atë me kontekstin shqiptar. Mendimi i njerëzve që ky ligj i prekte më shumë, komuniteti i medias, nuk u konsiderua ndërkohë që u përgatit ligji. Për pasojë, së shpejti komuniteti i medias u përball me një ligj që mund të konsiderohej shtypës.

Ligji nr. 7756 u shfuqizua tërësisht nga legjislatura e ardhshme në 1997. Për momentin, media e shkruar rregullohet me Ligjin për shtypin, i cili përbëhet vetëm nga ky pohim i përgjithshëm: "Shtypi është i lirë. Liria e shtypit mbrohet me ligj." Komisioni Parlamentar për Median, komuniteti i gazetarëve, avokatët dhe të tjerë, në periudha të ndryshme që nga 1997 kanë debatuar për nevojën për një ligj më të hollësishëm për shtyp dhe për formën e mundshme që mund të merre ai, si edhe për pasojat që do të kishte për zhvillimin e medias, e për rrjedhojë edhe në konsolidimin e demokracisë. Megjithatë, deri tani kanë mbizotëruar përpjekjet për vetërregullim dhe jo rregullimi i tepërt.

Krejt ndryshe, rregullimi i medias elektronike u bë me anë të një ligji të hollësishëm, Ligji Nr.8410 "Për Radion dhe Televizionin Publik dhe Privat." Ky ligj, i cili është amenduar gjashtë herë që nga miratimi i tij në 1998, ka për qëllim të rregullojë me hollësi aktivitetin e medias elektronike, përfshirë këtu edhe transmetuesin publik, televizionin privat, transmetimin kabllor dhe satelitor. Në 2007 Parlamenti miratoi edhe Ligjin për Transmetimet Numerike, por i cili nuk u zbatua kurrë.

Ligji për Radion dhe Televizionin krijoi bazën edhe për krijimin e Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit (KKRT) si organi kryesor rregullator si dhe për krijimin e Këshillit Drejtues të Radios dhe Televizionit Shqiptar (KDRTSH) si organin më të lartë drejtues të transmetuesit publik. Autoriteti rregullator është një nga fushat që vazhdimisht është dyshuar për ndërhyrje të politikës – duke u përfshirë në zgjedhjen e anëtarëve të KKRT, duke kontestuar vendimet e saj apo me mjete të tjera. Të gjitha këto shpesh e kanë ndërlikuar marrëdhënien mes rregullatorit dhe transmetuesve. Në 2006 u bënë ndryshime të rëndësishme në kuadrin rregullator.

Duke pretenduar që formula e përfaqësimit të balancuar të partive politike në organin rregullator nuk kishte funksionuar, qeveria paraqiti një projektligj që propozonte një përfshirje më të madhe të shoqërisë civile, shoqatave të medias, akademikëve, si dhe të aktorëve të tjerë për të propozuar grupin e kandidatëve për rregullatorin. Amendamentet ligjore e ndryshuan përbërjen e autoriteteve rregullatore nga një formulë e një përfaqësimi të balancuar politik në një përfaqësim më profesional. Megjithatë, mënyra e nxituar se si u ndryshua ligji—me një sesion parlamentar ku mori pjesë vetëm shumica—ngriti pikëpyetje për qëllimet e shumicës qeverisëse në lidhje me këtë ligj.

Pas firmosjes së Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit (MSA) me Bashkimin Europian në 12 qershor 2006, integrimi në BE ka qenë ndër prioritetet më të larta për qeveritë shqiptare. Synimi për të hyrë në BE u kthye në një motor reforme, ndërsa MSA shërbeu si katalizator për ndryshime konkrete. Në këtë kontekst, harmonizimi i legjislacionit shqiptar me standartet dhe legjislacionin e BE ishte një nga fushat ku nevojitej reformë urgjente në vend, përfshi këtu edhe legjislacionin për median audiovizive.

Ligji për Mediat Audiovizive

Më 4 Mars 2013, Parlamenti Shqiptar miratoi Ligjin 97/2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë,” pas gati gjashtë vitesh diskutimesh dhe bllokimi. Ky ligj ka si qëllim harmonizimin e legjislacionit shqiptar të medias me Direktivën e Shërbimeve të Medias Audiovizuale (2010/13/EU – AVMSD) të Bashkimit Evropian si dhe t’i përgjigjet realitetit të sektorit të mediave audiovizuale. Të dy krahët e politikës ranë në konsensus për ligjin, me përjashtim të procedurës së zgjedhjes së anëtarëve të autoritetit rregullator. Në fakt mos rënia dakort mbi një formulë të përshtatshme ka rezultuar të jetë një sfidë e vazhdueshme dhe shkak për luftë politike.

Më konkretisht ligji rregullon sektorët e mëposhtëm:

- përcakton mënyrën se si zgjidhet, kompetencat, funksionet, financimin dhe përgjegjësinë e autoritetit rregullator AMA;
- përkufizon kushtet dhe detyrimet për shërbimet e transmetimit, llojet e licensave dhe procedurave që duhen ndjekur;
- rregullon komunikimet audio ose audiovizive me natyrë tregtare, reklamat;
- vendos rregulla për përmbajtjen e transmetuar nëpërmjet Kodit të Transmetimit;
- përcakton mënyrat e ankimimit të vendimeve të AMA;
- përcakton rregullat e licensimit për transmetimet numerike;
- vendos rregulla për shërbimet on-demand dhe ato me akses të kushtëzuar;
- përcakton modalitetet për transmetimin e ngjarjeve me rëndësi për publikun;
- rregullon kundërvajtjet administrative dhe sanksionet.

Një kapitull i rëndësishëm i ligjit është edhe ai për transmetuesin publik, Radio-Televizioni Shqiptar (RTSH,) ku:

- përcaktohen organet drejtuese, funksionimi, kompetencat, zgjedhja dhe emërimi i tyre, papajtueshmëritë, etj.;
- krijimi i një Këshilli për Shikuesit dhe Dëgjuesit pranë RTSH, gjë që do të mundëson vendosjen e një lidhjeje të drejtpërdrejtë me publikun;
- mënyrën dhe burimet e financimit, natyrën dhe mënyrën e shfrytëzimit të pasurive të paluajtshme të RTSH;
- parimet bazë dhe deklaratën e qëllimit të programeve të RTSH, etj.

Konteksti i zbatimit të Ligjit për Mediat Audiovizive

Dy vjet pas hyrjes në fuqi të ligjit, ka pasur probleme të shumta që kanë penguar ose ngadalësuar zbatimin e tij. Arsyet janë të shumta, komplekse dhe janë pasoja të gjithë mënyrës se si është zhvilluar media në Shqipëri. Shqipëria ka një peizazh të pasur dhe dinamik të medias, me rreth 250 organe të medias, 25 gazeta të përditshme. Për momentin ka dy televizione kombëtare komerciale, TV Klan dhe Top Channel TV, 64 televizione lokale analoge dhe 115 televizione lokale kabllorë¹. Nga të gjithë stacionet televizive ekzistuese analoge, transmetuesi publik Radio Televizioni Shqiptare (RTSH) ka shtrirjen më të madhe: sinjali i tij mbulon 87 përqind të territorit². Gjithashtu ka edhe tre platforma dixhitale, Digitalb, Tring dhe Supersport. Supersporti është pjesë e platformës Digitalb.

Përveç këtyre ka edhe 65 stacione radios lokale dhe dy kombëtare Top Albania Radio dhe +2 Radio, si dhe transmetuesi publik Radio Tirana.³ Megjithatë, stacionet e radios janë më tepër mjete zbavitje me muzikë kryesisht, e ndërthurur me lajme flesh dhe programe talk shoë.⁴

Përpara se të miratohej ligji i parë për transmetimet, Ligji mbi Radion dhe Televizionin në vitin 1998, transmetimi televiziv në Shqipëri ka qënë i paligjshëm. Kur në vitin 2000 rregullatori i parë, KKRT, filloi aktivitetin e vet, shumë operatorë kishin filluar aktivitetin e tyre dhe nuk i bindeshin autoritetit të ri. Kjo situatë shpjegon pjesërisht vështirësitë e hasura nga KKRT më parë por edhe nga AMA tani. Edhe sot, autoriteti rregullator nuk është gjithmonë i suksesshëm në imponimin tërësor të përgjegjësive të tij të shumta. Monitorimi se si zbatohet Ligji për Mediat Audiovizive duhet të shihet edhe në këtë kontekst, ku rregullatori nuk ka arritur gjithmonë ta vendosë përtej çdo dyshimi autoritetin e tij në tregun e medias shqiptare.

Autoriteti rregullator dhe zbatimi i Ligjit për Mediat Audiovizive

Puna e AMA-s ka qënë nën ndikimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të aktorëve politikë në vend. Së pari, procedura e emërimit për anëtarët e AMA-s ndikohet nga situata politike. Në

¹ AMA: <http://ama.gov.al/previeë/mediat/tv/>, <http://ama.gov.al/previeë/mediat/kabllor/>

² AMA, Raporti Vjetor 2014, f. 9

³ AMA Lista e transmetuesve radiofonik: <http://ama.gov.al/previeë/mediat/radio/>

⁴ ISHM, Media dhe shoqëria e informacionit në Shqipëri, Tirana, 2011, fq.8.

periudha kur konsensusi politik nuk mund të arrihej, duke kulmuar me bojkotin e parlamentit nga opozita, partitë politike nuk pranuan të emëronin anëtarë, ose anëtarët nuk mund të zgjidheshin për shkak të mungesës së kuorumit. Kjo vlen si për një krah politik, ashtu edhe për tjetrin, ku institucionet e pavarura dhe zgjedhja e tyre është kthyer rëndom në pjesë të betejës politike. Po ashtu, ky është një problem i trashëguar edhe nga ligji i vjetër, edhe për faktin se nuk ka ndryshim rrënjësor në formulën e zgjedhjes midis dy ligjeve. Për shembull, në 2007, kur opozita refuzonte të merrte pjesë në parlament, numri i anëtarëve të KKRT u ul në katër anëtarë pas dorëheqjes së kryetarit Ledi Bianku në qershor 2007. Derisa vendet bosh u plotësuan në shtator 2007, KKRT ka marrë vetëm vendime që nuk kërkonin një shumicë. Kjo gjë pengoi punën e saj. Po ashtu, si pasojë e bojkotimit të parlamentit nga opozita në vitet 2009-2010, u vonua edhe zgjedhja e anëtarëve që mungonin në KKRT⁵.

Pesë vite më vonë dhe me një ligj të ri në fuqi situata nuk ka ndryshuar aspak. Komisioni Parlamentar i Medias për shumë muaj gjatë vitit 2014 nuk ra dakort mbi termat e vlefshmërisë së mandatit të kryetares së AMA. Mazhoranca pretendonte se ishte e paligjshme që kryetarja e AMA të mbante pozicionin e saj pasi mandati i saj kishte mbaruar dhe ajo nuk ishte rizgjedhur si anëtare e AMA, duke akuzuar opozitën se po bllokonte procesin e kthimit të rregullatorit në një proces normal. Në anën tjetër opozita argumentonte se mazhoranca po shkelte ligjin me qëllim që ta kontrollonte politikisht rregullatorin. Me pak fjalë beteja politike dhe debati i gjatë vonuan zgjedhjen e anëtarëve të rinj duke paralizuar AMA-n. Më në fund Parlamenti zgjodhi kryetarin dhe dy anëtarët e rinj të organit rregullator vetëm me votat e shumicës. Opozita e denoncoi procesin duke thënë se ligji qartësisht kërkon që lista e kandidatëve të përpilohen në bashkëpunim nga mazhoranca dhe opozita. Në këtë kontekst dy nga anëtarët e mbetur të AMA të caktuar nga opozita kanë refuzuar të marrin pjesë në vendimmarrje derisa gjykata të vendosë mbi këtë çështje që do të thotë se AMA-s i mungon kuorumi i nevojshëm për të marrë vendime të rëndësishme që kërkojnë pesë vota. Kjo ka ndikuar negativisht në të gjithë zbatimin e ligjit si dhe në procesin e kalimit në dixhital, pasi kjo është një nga arsyet që e pengon AMA të vendosë mbi dhënien e licensave dixhitale si dhe për vendime të tjera që kanë nevojë për kuorum.

⁵ ISHM, Raporti për Monitorimin e KKRT, 2011.

Përveç mënyrës se si u zgjodhën kryetari dhe anëtarët e rinj të AMA, opozita kontestoi edhe zgjedhjen e kryetarit duke thënë se eksperiencia e tij e mëparshme si drejtor i një nga platformave komerciale kryesore në vend ishte tregues se si qeveria dhe media komerciale po përpiqeshin të kapnin për interesat e tyre rregullatorin. Aktualisht çështja është në gjykatën administrative. Edhe kjo nuk është një risi për ambientin mediatik shqiptar. Anëtarët e rregullatorit shpesh janë të lidhur, kanë punuar më parë, ose shkojnë të punojnë pas largimit nga ky institucion për institucione dhe parti politike. Për anëtarët e rregullatorit të mëparshëm thuhej: “fakti që kryetarja në Këshillin e tanishëm më parë kishte shërbyer si këshilltare e Kryeministrit, ndërsa një prej anëtarëve ishte këshilltare e Kryetares së Parlamentit, si dhe një tjetër anëtar kishte punuar më parë si zëdhënës në një prej ministrive, ka hedhur dyshim mbi respektimin praktik të kriterëve për emërimin e anëtarëve të Këshillit.”⁶

Po kështu, kryetari i tanishëm i AMA është konsideruar si njeri i njërës prej mediave më të fuqishme në vend, për shkak të përvojës së tij të mëparshme të punës, gjë që gjithashtu ka hedhur dyshime për zbatimin me korrektësi të ligjit nga ana e AMAs. Vendime madhore të rregullatorit vazhdojnë të vihen në dyshim dhe të kontestohen. Për shembull, miratimi i rregullores së beauty contest për licensat për rrjetet dixhitale nga rregullatori u kontestua nga platforma Tring dhe televizioni Vizion+, të cilët pretendonin se thirrja për të aplikuar nuk kishte patur parasysh mundësitë e barabarta dhe favorizonte operatorë të caktuar në treg, duke anashkaluar të tjerët. Në fakt, përveç klimës politike që ndikon në funksionimin e rregullatorit të transmetimeve, ekziston edhe pikëpamja se “presioni vjen kryesisht nga komuniteti i biznesit dhe ky nuk është politik, por ekonomik. Operatorët e fuqishëm të medias i kanë zgjidhur çështjet e tyre drejtpërdrejt me të dy krahët politikë. Për pasojë, kohët e fundit nuk ka pasur trysni politike në vendimet e rregullatorit, por kryesisht ekonomike. Kjo mund të vijë për faktin që është periudhë tranzicioni dhe çështjet në diskutim kanë qenë më shumë të një natyre teknike sesa politike.”⁷

Për rrjedhojë, nga mënyra e zgjedhjes, konsiderata e opozitës së tanishme për kryetarin e AMA dhe arsye të tjera, puna e AMA në drejtim të zbatimit të ligjit ka qenë e penguar dhe e vonuar. Anëtarët e rinj dhe kryetari u zgjodhën 18 muaj pas miratimit të Ligjit për Mediat Audiovizive.

⁶ Londo, Zhvillimi i Medias Dixhitale në Shqipëri, 2012.

⁷ Intervistë me Enio Haxhimihali, ekspert i legjisllacionit për median, 4 nëntor 2013.

Për shembull, sipas nenit 21 të këtij ligji, AMA duhet të miratonte brenda 5 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit Strategjinë e saj, ku pasqyron mënyrën e realizimit të funksioneve të veta ligjore. Dy vjet pas miratimit të ligjit, AMA sapo ka filluar të punojë në këtë drejtim. Po kështu, problemet me kuorumin vazhdojnë të pengojnë marrjen e vendimeve për licenca apo vendime të tjera të rëndësishme, duke ngadalësuar akoma më shumë zbatimin e ligjit.

Televizioni publik dhe roli i tij në zbatimin e Ligjit për Mediat Audiovizive

Ligji për Mediat Audiovizive përcakton tri organe qeverisëse për RTSH: Këshillin Drejtues, Drejtorin e Përgjithshëm dhe Bordin e Administrimit. Nga këto, Këshilli Drejtues është organi më i lartë. Ashtu si dhe me AMA-n, emërimi i anëtarëve të këshillit ka qenë një problem madhor në debatin politik dhe publik, shpesh duke penguar funksionimin normal të operacioneve të RTSH. Kështu, anëtarët e tanishëm të Këshillit Drejtues u zgjodhën në dhjetor 2015, ndërkohë që të gjithë anëtarëve të mëparshëm u kishte mbaruar mandati për të paktën një vit, disave edhe për dy. Kjo do të thotë se RTSH ka funksionuar pa Këshill Drejtues legjitim, praktika që vënë në pikëpyetje nëse vërtet Këshilli Drejtues është organi më i lartë siç thotë dhe ligji. Kjo jo aq për faj të RTSH, por për pasojë të mbetjes peng të zgjedhjes së autoriteteve të pavarura nga lufta politike dhe mosmarrëveshjet në parlament. “Mosmarrëveshja politike që ka vazhduar gjatë viteve ka çuar në vështirësi në zbatimin e ligjit dhe mundësimin e një funksionimi normal të institucionit.”⁸

Po kështu, ashtu si dhe me AMA, një problem i rëndësishëm lidhur me këshillin ka qenë ai i përkatësive politike të anëtarëve të tij. Miratimi i ligjit të ri për mediat audiovizive në mars 2013 dështoi ta trajtonte dhe zgjidhte këtë problem. “Amendamentet e vazhdueshme për formulën dhe kriteret për zgjedhjen e anëtarëve, së bashku me formulën në ligjin e ri tregojnë një prirje ku balanca politike ka pasur përparësi më të lartë dhe ka qenë diçka më e sigurt sesa kredencialet

⁸ Londo, *Public Service Media Face Political and Financial Challenges*, Flash report, SEE Media Observatory, 2013. Gjetet në: <http://mediaobservatory.net/radar/flash-report-albania>.

politike.”⁹ Ndonëse ligji kërkon një përvojë të gjatë në lidhje me median dhe fusha të tjera, me një përfaqësim të gjerë grupesh, përfshi edhe OJQ dhe grupe interesi të ndryshme, mbeten pretendimet se në thelb, shumica e anëtarëve kanë ndikime dhe përkatësi politike. “*De jure* të gjitha grupet e interesit janë të përfaqësuara; *de facto* janë të përfaqësuara të gjitha ngjyrat politike.”¹⁰

Pavarësisht dyshimeve për pavarësinë e veprimit të Këshillit Drejtues, është e qartë që pengesa kryesore në këtë periudhë për funksionimin e RTSH dhe për zbatimin e ligjit ka qenë konflikti i zgjatur politik që ka sjellë vonesa të mëdha në zgjedhjen e Këshillit Drejtues. Po kështu, edhe pasi dy krahët politikë ranë dakord për Këshillin Drejtues, konflikti dhe ndarja politike u shtri në zgjedhjen e Drejtorit të Përgjithshëm. Duke parë se zgjedhja e tij kërkon shtatë vota, ndarja politike e anëtarëve të Këshillit Drejtues nuk e ka bërë të mundur që të zgjidhet drejtori, duke sjellë edhe sugjerime të mazhorancës për të ndryshuar ligjin në këtë pikë. Gjithsesi, mbetet realitet që prej nëntë muajsh pas zgjedhjes së Këshillit Drejtues, ende nuk janë zgjedhur strukturat drejtuese, që sjell edhe vonesa në aspekte të tjera të zbatimit të ligjit.

Për shembull, sipas nenit 112, “RTSH-ja krijon këshillin për shikuesit dhe dëgjuesit brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji,” gjë që ende nuk ka ndodhur, edhe pas dy vitesh e gjysmë që ligji është në fuqi. Një tjetër dokument i rëndësishëm dhe risi e ligjit është dhe Kontrata e Transmetimit Publik. “RTSH-ja, pas realizimit të një konsultimi publik, përgatit, jo më vonë se 1 vit nga hyrja në fuqi e këtij ligji dhe më pas çdo 5 vjet, një kontratë të shërbimit të transmetimit publik, ku përcakton parimet që zbaton dhe veprimtaritë që merr përsipër për përmbushjen e qëllimeve të veta si transmetues publik, të cilën ia paraqet AMA-s.” Edhe ky dokument, megjithëse përcakton parimet dhe drejtimin kryesor të transmetimeve për publikun dhe përmbajtjen e tyre, ende nuk është përgatitur, jo më të diskutohet në këshillime publike. Në të njëjtën linjë, Statuti i RTSH, i cili duhej të rishkruhej brenda 3 muajsh nga hyrja në fuqi e ligjit, edhe pse është botuar online si draft në faqen e RTSH, ende nuk është diskutuar apo miratuar në Këshill Drejtues. Përveç vonesave në hartimin e dokumenteve bazë, problemi i ndarjes së votave në Këshill Drejtues për procese themelore mbetet. Kështu, sipas nenit 99 të ligjit, “Vendimet e

⁹ Ibid.

¹⁰ Intervistë me Mirela Oktrova, drejtoreshë e *Televizionit Shqiptar*, 28 janar 2014.

KDRTSH-së për miratimin e rregullores së veprimtarisë së tij, statutin e RTSH-së dhe emërimin ose shkarkimin e Drejtorit të Përgjithshëm quhen të miratuara, kur për to votojnë pro jo më pak se 7 anëtarë.” Duke pasur parasysh që televizioni publik është edhe në fazën delikate të dixhitalizimit, ku publiku, por edhe media të tjera lokale janë të varur nga ky proces, fakti që vendimmarrja është e bllokuar ose me vonesa të mëdha nuk është aspak një rrethanë lehtësuese.

Një tjetër problem i rëndësishëm përse i përket dixhitalizimit të televizionit publik ka qenë edhe vonesa që u shkaktua në tenderin për ndërtimin e dy rrjeteve dixhitale që do të jenë në përdorim të RTSH. Strategjia për Kalimin në Transmetime Numerike i dha dy frekuenca kombëtare transmetuesit publik, nga tetë që i janë caktuar Shqipërisë. Ministria e Inovacionit dhe ICT publikoi një thirrje për propozim në prill 2013 në lidhje me ndërtimin e këtyre dy rrjeteve. Tenderi u zhvillua mes debatesh të opozitës që deklaronte se nuk ishte momenti i përshtatshëm për ndërmarrjen e projekteve të këtyre përmasave menjëherë para periudhës zgjedhore. Pasi u shpallën dy kompani fituese, procesi u kundërshtua nga kompania që pretendonte se kishte shkelje ligjore në shpalljen e dy fituesve. E përballur me këtë situatë dhe me një rotacion të menjëhershëm të pushtetit pas zgjedhjeve të përgjithshme të qershorit 2013, Ministri nxorri Urdhërin nr.15, datë 29/08/2013, një urdhër që anulonte të gjitha procedurat e tenderit. Megjithatë, ndërimi i pushteteve nuk e pengoi një nga kompanitë fituese të vazhdonte betejën ligjore, me një çështje që shkoi në disa gjykata, derisa Ministria vendosi të ndalonte apelimin e çështjes dhe Gjykata Administrative e Apelit nxorri Vendimin nr.3407, datë 15.09.2014¹¹, e cila vendosi që çështja ishte mbyllur. Menjëherë pas vendimit të gjykatës Urdhër nr.3663, datë 29.09.2014, u publikua në Buletinin për Prokurimet Publike nr.41, datë 13.10.2014¹², i cili e shpallte kompaninë si fituesin e vetëm të tenderit për ndërtimin e rrjeteve dixhitale për transmetuesin publik RTSH. Mbasi u mbyll kjo odise ligjore, RTSH dhe qeveria nënshkruan kontratën me kompaninë gjermane Rohde & Schëarz më 19 mars, 2015. Megjithatë duke marrë parasysh vonesat në formimin e Këshillit Drejtues dhe në zgjedhjen e Drejtorit të Përgjithshëm, si dhe vonesat e shkaktuara nga mosmarrëveshjet ligjore, ngritja e rrjeteve dixhitale është vonuar

¹¹ <http://www.gjykataadministrativeapelit.al/>

¹² www.app.gov.al

shumë duke influencuar kështu jo vetëm RTSH, por edhe transmetuesit lokalë që supozohen t'i përdorin këto rrjete.

Licensimi i rrjeteve numerike

Përveç funksionimit të kushtëzuar të autoritetit rregullator dhe vonesave në nënshkrimin e kontratës për ngritjen e rrjeteve dixhitale të RTSH, procesi i licensimit të rrjeteve komerciale dixhitale ka qenë një tjetër problem i rëndësishëm në lidhje me zbatimin e ligjit për mediat audiovizive. Me vendimin “Mbi licensimin e rrjeteve dixhitale dhe programeve të tyre nëpërmjet procedurave të beauty contest,” datë 2 korrik, 2013, rregullatori AMA bëri thirrje për licensimin e operatorëve komercialë dixhitalë, duke ftuar operatorët historikë të aplikojnë. Të tre operatorët, Digitalb, Top Channel, dhe Media 6, ngritën një padi duke kundërshtuar Paragrafin 16 të kesaj rregulloreje. Ata gjithashtu kërkuan se bazuar në pavlefshmërinë e këtij paragrafi, gjykata duhet ta shpallte si të pa vlefshëm të gjithë rregulloren. Operatorët pretendojnë se AMA ka vepruar përtej kompetencave të saj në vendosjen e masave financiare që operatorët duhet të përmbushin për të marrë një licensë. AMA argumentoi se operatorët nuk i kishin ezauruar të gjitha masat ligjore dhe se ata fillimisht duhet të kishin bërë ankesën administrative. Në 30 korrik, 2013, gjykata hodhi poshtë argumentin e AMAs dhe vendosi të pranonte procedimin e Digitalb, Top Channel & Media 6 dhe pezulloi rregulloren¹³. Gjykata e shkallës së parë vendosi që AMA nuk kishte paraqitur prova të mjaftueshme për këto pretendime. Si rrjedhim rregullat dhe procedurat mbi licensimin e rrjeteve dixhitale u pezulluan deri në vendimin përfundimtar të gjykatës.

AMA e apeloj vendimin e gjykatës për pezullimin e rregullores në Gjykatën e Apelit më 5 Gusht 2013, dhe më vonë në Gjykatën e Lartë. Gjykata e Lartë kerkoi plotësimin e dosjes ligjore nga një gjykatë e shkallës së parë, e cila u përgjgj se aktualisht dosja po shqyrtohet në shkallë të parë të Gjykatës Administrative. Kjo ishte pas vendimit të marrë nga Gjykata e Tiranës në 21 Janar, 2014. Gjykata e shkallës së parë kishte vendosur se objekti i kësaj padie kishte lidhje me procedurat administrative. Si rezultat gjykata u deklarua jo kompetente për t'u marrë me këtë çështje duke i dërguar vendimet në gjykatën kompetente, të quajtur niveli i parë i Gjykatës

¹³ www.gjykatatirana.gov.al

Administrative të Tiranës. Pasi shqyrtoi të gjitha aktet ligjore të dosjes, Gjykata e Lartë deklaroi se vendimi i shkallës së parë për të refuzuar kërkesën e AMAs që konsideronte padinë e operatorëve si jo ligjore, në bazë të mosezaurimit të ankesës administrative, ishte i vlefshëm.

Paralel me vendimet e Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës së Lartë, pas vendimeve të Gjykatës së Tiranës datë 21 Janar, 2014, padia e Digitalb, Top Channel & Media 6 vs AMA u shqyrtua nga shkalla e parë e Gjykatës Administrative dhe pastaj nga Gjykata Administrative e Apelit. Kjo e fundit e pranoi padinë me Vendim nr.17, datë 8 Tetor, 2014¹⁴, duke anuluar paragrafin 16 të rregullores dhe duke zbatuar pezullimin e procesit të lincensimit.

Së fundmi padia dhe vlefshmëria e Vendimit të Gjykatës së Tiranës për ta transferuar akt padinë në Gjykatën Administrative u mor parasysh nga Gjykata e Apelit. Në 17 Tetor, 2014, kjo gjykatë konfirmoi se Gjykata e Tiranës kishte të drejtë që transferoi akt padinë, pasi i mungonin kompetencat për të vendosur mbi këtë çështje. Për më tepër vendimi u mor pasi si AMA dhe përfaqësuesi i Avokatit të Shtetit deklaruan se të dyja shkallët e Gjykatës Administrative kishin vendosur mbi këtë çështje duke e konsideruar atë si të mbyllur. Si rezultat pas këtyre vendimeve të gjykatës si dhe zgjedhjes së anëtarëve të rinj të AMA, organi rregullator vendosi të pushonte procedimin ligjor dhe të amendonte rregulloren. Megjithëse rregullatori ishte i lirë të procedonte më shumë se një vit shkoi dëm në mosmarrëveshje ligjore mbi këtë çështje.

Rregullatori më në fund rishikoi rregullat mbi licensimin dhe mbas konsultave me operatorët ekzistues bëri thirrje për aplikim në prill 2015¹⁵. Thirrja u kontestua nga Vizion+ dhe Tring TV, duke kërkuar pezullimin e procedurave. Aktualisht çështja është në gjykatë dhe Tring, megjithëse u ftua të merrte pjesë nuk aplikoi. Katër operatorët historikë morën pjesë në garë, dy televizionet kombëtare TV Klan dhe Top Channel, dhe dy platformat ekzistuese dixhitale: Digitalb dhe Supersport. Mbetet për t'u parë nëse AMA do të jetë në gjendje të marrë vendime mbi licensat për shkak të mungesës së kuorumit në bordin e saj.

Për më tepër edhe me katër aplikantë, ka një problem lidhur me strukturën e tyre të pronësisë dhe kërkesës ligjore të imponuar në këtë aspekt. Përderisa tre nga katër operatorët kanë pak a

¹⁴ <http://www.gjykataadministrativeeapelit.al/>

¹⁵ www.ama.gov.al

shumë të njëjtët pronarë, kufizimi aktual i pronësisë në Ligjin për Median Audiovizuale është pengesë për marrjen e licensave respektive. Sipas paragrafit 62 mbi Ligjin për Median Audiovizuale, “asnjë person ligjor i huaj apo vendas nuk duhet të ketë më shumë se 40 përqind të kapitalit të përgjithshëm të një kompanie të përbashkët që ka një licensë kombëtare transmetimi apo një licensë kombëtare për transmetime audiovizuale.”¹⁶ Për më tepër pronari i një kompanie me licensë kombëtare nuk mund të zotërojë më shumë se 20% në një kompani tjetër që posedon një licensë kombëtare. Ky rregull qartësisht kufizon numrin e licensave kombëtare që AMA mund t’i japë aplikantëve aktualë me strukturën e tyre të pronësisë.

Në këtë kontekst Taulant Balla, deputet i Partisë Socialiste, në 24 prill 2015 paraqiti një propozim në Parlament për amendimin e Ligjit për Median Audiovizuale. Ndryshimi i propozuar përmbante vetëm paragrafin e mëposhtëm: “Paragrafi 62 i ligjit nr. 97/2013 ‘Mbi median audiovizuale në Republikën e Shqipërisë’ shfuqizohet.” Ndryshimi i propozuar nga Balla pretendon se ky paragraf ka krijuar pengesa që duhet të eliminohen pasi ato përbëjnë “një pengesë reale ndaj zhvillimit të transmetimit.” Sipas raportit që shoqëron ndryshimin e propozuar, pengesat e pronësisë janë të panevojshme dhe ai gjithashtu pretendon se “nën situatën aktuale, konkurrenca efektive dhe e ndershme është shkelur rëndë, cilësia e shërbimeve audio dhe audiovizuale mund të bjerë dhe një nga parimet kryesore mbi të cilin AMA duhet të ushtrojë aktivitetin e saj, atë të garantimit të aksesit të barabartë dhe jo diskriminues të tregut audio dhe audiovizual të medias, mund të shkelet.” Heqja e këtyre kufizimeve sigurisht që do të zgjidhte dilemën e AMAs në dhënien e një numri të kufizuar licensash për aplikantët aktualë. Megjithatë, ajo do të çonte në një përqendrim të pronësisë për rrjetet dixhitale që do të licensoheshin si dhe asnjë garanci për pluralizmin e medias në të ardhmen e procesit të licensimit. Opozita e kundërshtoi hapur këtë propozim duke pretenduar se propozimi ka për qëllim që të hapi rrugën për vendosjen e monopoleve në tregun e medias. Mazhoranca dhe opozita në Komisionin Parlamentar të Medias vendosën të kërkonin ndihmën e OSBE, Komisionit Evropian dhe Këshillit të Evropës përpara se të ndërmerren vendimin përfundimtar mbi ndryshimet e propozuara dhe një rekomandim për të votuar në seancën parlamentare. Mbetet për t’u parë se si parlamenti dhe aktorët e tjerë do ta trajtojnë këtë çështje delikate me pasoja të mëdha për

¹⁶ Ligji 97/2013, parag.62.

pluralizmin e medias. Megjithatë rregullimi i pronësisë është një tjetër faktor që mund ta vonojë më tej procesin tashmë të stërvonuar të kalimit në dixhital, si dhe zbatimin e ligjit për mediat audiovizive.

Përfundime

Zbatimi i Ligjit për Mediat Audiovizive mund të thuhet se është ende në fillesat e tij. Ashtu si u vonua miratimi i ligjit, po vonohet dhe ngadalësohet dhe zbatimi i tij. Arsyeja kryesore për këtë është vonesa dhe pengesa që sjell mosmarrëveshja politike mes dy partive kryesore, që sjell bllokimin e funksionimit normal të autoriteteve rregullatorë dhe institucioneve përgjegjëse për zbatimin e ligjit. Shpesh këto marrëveshje vonojnë edhe zgjedhjen e anëtarëve të rinj, duke vënë në pikëpyetje kuorumin dhe vendimmarrjen. Përveç problemeve me kuorumin, puna e ngadaltë e institucioneve për të filluar zbatimin e ligjit duke hartuar dokumenta strategjike është gjithashtu për t'u shënuar, ndoshta e ndikuar edhe nga mungesa e anëtarëve të bordeve që i miratojnë këto dokumente. Po kështu, ka patur raste që zbatimi i ligjit është penguar edhe si pasojë e interesave komerciale dhe proceseve të zgjatura gjyqësore, që kanë pezulluar ose ngadalësuar veprime të rregullatorit apo tenderin për dixhitalizimin e RTSH. I njëjti presion vihet re edhe me tentativat për të ndryshuar rregullat për pronësinë për mediat audiovizive, që paralajmëron një vonesë akoma më të madhe në zbatimin e ligjit, si dhe pikëpyetje më të rëndësishme që mund të vijnë nga këto ndërhyrje për të ardhmen.